



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 63 Akti

Nr. 90 Vendimi
Tiranë, më 20.12.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare
Xhensila Pine	Relatore

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, më datë 19 dhjetor 2018, ora 16:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati i 0, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Adnand Kosova**, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Xhensila Pine, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit,

pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tri kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, ushtron detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur, më datë 15.01.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shpërndarë me short çështja konkrete.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues, më datë 24.01.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, znj. Pamela Qirko. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme.

6. **Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI)** ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016; në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)**, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport, për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova*

8. **Prokuroria e Përgjithshme**, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.
9. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.
10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 03.12.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
11. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, më datë 03.10.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të tij më datë 06.12.2018.
12. Për arsye të marrjes me vonesë të njoftimit me *e-mail*, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesën për shtyrjen e afatit të paraqitjes së provave dhe parashtrimeve.
13. Trupi gjykues vendosi të shtyjë afatin e caktuar për paraqitjen e provave dhe parashtrimeve, nga data 12.12.2018 në datën 17.12.2018.
14. Pas administrimit e shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.
15. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 17.12.2018.
16. Trupi gjykues e konsideroi të panevojshme marrjen e dëshmive të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit, të shtetasve E. K, A. A. K, A. P. S, A. I. M, R. R. K, S. Ç. M., për arsye se fakti që kërkohej të provohet nga subjekti i rivlerësimit, konsiderohet i provuar gjatë gjykimit të çështjes administrative nga trupi gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 19.12.2018, ora 16:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i 0, salla B, Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.
18. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në Aneksin e Kushtetutës, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” si dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- b) Deklaratat vjetore të pasurisë si dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- d) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) Shpjegimet me shkrim dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit;

22. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Pas hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezultoi se ka në pronësi pasuri të paluajtshme si vijon:

23. Apartament banimi, me sipërfaqe 98 m², me adresë: Rr. “****”, pallati i ***, në proces legalizimi, në vlerën 19.600 USD.

24. Mënyra e krijimit: me kontratë porosie individuale, më datë 09.02.1998, tek “****” sh.p.k., me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.02.1998.

25. Burimi i krijimit: Kursimet nga paga si prokuror dhe paga e bashkëshortes; të ardhura nga mësimdhënia në Universitetin “Fan Noli” Korçë; të ardhura nga shitja e apartamentit në Korçë.

26. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratat periodike si vijon:

- Në deklarinimin për vitin 2003 deklarohet, “apartament banimi, me sipërfaqe 100 m², në vlerën 2.6 milion lekë”. Burimi: Shitja e apartamentit të banimit në Korçë dhe kursimet. Banesa është shitur në vlerën 2.5 milion lekë;
- Në deklarinimin periodik për vitin 2017 deklarohet, “apartament banimi, me sipërfaqe 98 m², në vlerën 19.600 USD”.

27. Nga hetimi administrativ rezultoi se:

28. ALUIZNI, me shkresën nr. *** prot., datë 23.01.2015, informon se shtetasi Adnand Ç. Kosova ka aplikuar për legalizimin e ndërtimit informal me adresë: Rr. “****”, pallati ***, shkalla ***, apartamenti ***, Tiranë.

29. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me shkresat me nr. *** prot., datë 12.02.2018 dhe nr. *** prot., datë 15.02.2018, informon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të nuk figurojnë pasuri aktuale apo të tjetërsuara.

30. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë me shkresat me nr. *** prot., datë 01.02.2018 dhe nr. ***prot., datë 08.02.2018, informon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë të regjistruar pasuri në regjistrin e pasurive të paluajtshme të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë. Sipas ZVRPP-së Korçë, z. Adnand Ç. Kosova, ka qenë pronar në pasuritë e mëposhtme, të tjetërsuara në persona të tretë.

- Nr. ***, ZK ***, vol. ***, fq. ***, e llojit apartament, me sipërfaqe 28.8 m², ndodhur në qytetin e Korçës;
- Nr. ***, ZK ***, vol. ***, fq. ***, e llojit apartament, me sipërfaqe 47.3 m², ndodhur në qytetin e Korçës.

31. Me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2018, drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, i është kërkuar informacion mbi çmimin mesatar të shitjes si dhe çmimin e referencës për apartamentin e ZK ***, të qytetit të Korçës në vitin 2002 dhe vitin 1998.

32. Me shkresën kthim përgjigje me nr. *** prot., datë 02.11.2018, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, informon se çmimi minimal fiskal për apartamentet në qytetin e Korçës për vitin 1998, ka qenë 25.145 lekë/m², kurse për vitin 2002 ka qenë 29.635 lekë/m².

33. Referuar kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.06.2002, mes shitësit Adnand Kosova dhe blerësit E. K për shitjen e apartamentit me sipërfaqe 47.3 m² dhe shtesës

me sipërfaqe 28.8 m² në qytetin e Korçës, për mospërputhjet mes çmimit të shitjes në kontratën e shitblerjes në vlerën prej 1.000.000 lekësh dhe çmimit të deklaruar, ju kërkuan sqarime subjektit të rivlerësimit.

34. Në sqarimet e datës 18.09.2018, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në fund të vitit 1997 kishte aplikuar për të punuar në Tiranë dhe kishte rënë në marrëveshje me shtetasin E. K për ti shitur banesën në Korçë në vlerën 2, 5 milion lekë, me kusht që një pjesë të lekëve t'ia jepte paraprakisht si kapar dhe pjesën tjetër kur të lironte banesën.

35. Në vijim në sqarimet e tij të datës 27.09.2018, subjekti i rivlerësimit, mbas pyetjes së Komisionit mbi dokumentacionin ligjor provues për marrjen e shumës së kaparit prej 1.5 milion lekësh në vitin 1998, deklaroi se për marrjen e kësaj shume prej 1.5 milion lekësh nga shtetasi Emiljano Kalemi ka pasur një deklaratë dore, të cilën nuk e disponon më.

35.1 Ai shpjegoi se në momentin që kontrata e shitblerjes është bërë përfundimisht dhe janë shlyer detyrimet mes palëve, nuk ka pasur arsye për ta ruajtur më gjatë këtë dokument, dhe se shuma e marrë kapar në vitin 1998 është përdorur përveç të ardhurave nga paga për pagimin e dy kësteve të apartamentit në Tiranë në po atë vit sipas mandatit nr. ***, të cilin e depozitoi pranë Komisionit në vlerën 1.900.000 lekë.

36. Në vitin 1998, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga vëllai i tij automjetin veturë, tip “Ford”, me targë ***.

37. Kjo pasuri është deklaruar në deklaratat periodike si vijon:

- Në deklarinimin për vitin 2003, në shumën prej 1 milion lekësh, blerë nga të ardhurat e tij dhe nga ndihma e familjarëve.
- Në deklarinimin për vitin 2009, deklarohet kontratë shitblerje e datës 18.02.2009 të një autoveture, tip “Ford”, shitur shtetasit B. C në vlerën 700. 000 lekë.

38. Nga hetimi administrativ rezultoi se:

39. Nëpërmjet kontratës nr. *** rep., datë 22.12.1998, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga vëllai i tij automjetin veturë, tip “Ford”, me targë ***.

40. Subjekti i rivlerësimit ka shitur këtë mjet në vitin 1999 sipas kontratës së shitjes së automjetit nr. *** rep., nr. ***kol., në datën 18.02.2009.

41. Trupi gjykues, mbas kryerjes së analizës financiare për periudhën e rivlerësimit 2003 - 2016, nuk rezultonte që subjekti të ketë pamjaftueshmëri financiare, vërejtji se për vitin 1998, rezultuan pamjaftueshmëri financiare.

42. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera e për të provuar të kundërtën lidhur me:

- i. pamundësinë financiare të tij për blerjen me të ardhura të ligjshme në vitin 1998 të apartamentit në Tiranë dhe automjetit të blerë nga vëllai i tij;
- ii. mungesën e dokumentacionit ligjor provues për marrjen e shumës kapar për shitjen e këtij apartamenti në vlerën 1.5 milion lekë në vitin 1998;
- iii. mospagimit e tatimit për shumën e marrë kapar për shitjen e këtij apartamenti në vlerën 1.5 milion lekë në vitin 1998, nga shitja e apartamentit në Korçë sipas legjislacionit në fuqi.

43. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se gjithë pasuria, deklaruar në deklaratën për procesin e rivlerësimit dhe që e disponon aktualisht, përbëhet nga:

- Banesa, ku banon aktualisht, e blerë në vitin 1998 në vlerën 2,5 milion lekë.
- Një autoveturë, të cilën e disponon aktualisht, blerë në vitin 2008 në vlerën 11.000 euro (1.350.000 lekë)
- Shuma prej 1.100.000 lekësh gjendje *cash*.

44. Në lidhje me pamundësinë financiare të tij për blerjen me të ardhura të ligjshme, në vitin 1998, të apartamentit në Tiranë dhe automjetit nga vëllai, subjekti shpjegoi se duhet të merret në konsideratë se çmimi i shitjes së banesës ka qenë 2.5 milion lekë dhe jo 1 milion lekë si është shënuar në kontratë, pasi shuma prej 1,5 milion lekësh është marrë paradhënie për shitjen e banesës nga shtetasi E. K, në fillim të muajit shkurt të vitit 1998.

45. Që në deklaratën periodike të vitit 2003, ai shpjegoi se ka deklaruar si burim të ardhurash për blerjen e apartamentit në Tiranë, kursimet nga pagat si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Korçë në vlerën 2.5 milion lekë, pa qenë nën presionin e procesit të “Vettingut”. Meqenëse ka qenë deklarata e parë që plotësonte në lidhje me pasurinë, nuk ka qenë i orientuar për të specifikuar apo saktësuar këtë shumë të deklaruar, ku përfshihej shuma prej 1.5 milion lekësh (*kapar*) marrë nga shtetasi E. K në fillim të muajit shkurt të vitit 1998 dhe shuma 1.000.000 lekë sipas kontratës për shitjen e apartamentit në Korçë në vitin 2002.

46. Në lidhje me pagimin e tatimit për shumën e marrë kapar në shkurt vitit 1998, subjekti i rivlerësimit, shpjegoi se të ardhurat tatonen për periudhën (vitin) kur ato realizohen, ndaj shuma 1.5 milion lekë marrë paradhënie nga shtetasi E. K në shkurt të vitit 1998, sipas ligjit të kohës kur ishte realizuar kjo e ardhur, përjashtoj nga tatimi, sipas ligjit tatimor të kohës (ligji nr. 8191, datë 30.01.1997). Efektet e këtij ligji kanë vazhduar deri momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

47. Në lidhje me dokumentacionin ligjor provues për marrjen e shumës kapar për blerjen e këtij apartamenti në vlerën 1.5 milion lekë në vitin 1998, subjekti shpjegoi se referuar parashikimet

ligjore të Kodit Civil, kapari nuk kërkon për efekt vlefshmërie formalizimin me shkresë, apo akt noterial, si mjet për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve civile dhe në këtë mënyrë nuk është e detyrueshme paraqitja e tij në formë shkresore.

48. Subjekti i rivlerësimit, për përlllogaritjet e shpenzimeve për jetesë për periudhën 1992-1998, nuk ka gjetur informacion nga INSTAT mbi shpenzimet për jetesë, të cilat datonin që nga viti 2002, ndaj duke marrë në konsideratë përqindjen e shpenzimeve për jetesë të llogaritura në tabelën e vitit 2008, ka bërë një llogaritje të përafërt të shpenzimeve për jetesë për vitet 1992 - 1998 në vlerën 40 % - 50 % të të ardhurave, për këtë periudhe.

49. Subjekti i rivlerësimit në lidhje me blerjen e makinës në vitin 1998 nga vëllai i tij shpjegoi se është rënë dakord ti paguaj paraprakisht vëllait vlerën 400.000 lekë, për blerjen e automjetit dhe për ti paguar pjesën tjetër në një periudhë të mëvonshme sipas shpjegimeve të dhëna nga vëllai në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 08.12.2018.

V. ANALIZA FINANCIARE

50. Gjatë hetimit administrativ është bërë një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare, të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore.

51. Nga analiza financiare për periudhën e rivlerësimit 2003 - 2016, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, nuk rezulton që subjekti të ketë pasur deklarime të pasakta dhe nuk rezulton që të ketë pasur likuiditete të pajustificuara

Periudha (viti)	Pasuritë	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
2004	800.000	0	2.464.316	650.000
2005	1.031.522	0	2.185.895	650.000
2006	780.333	0	2.098.777	650.000
2007	1.378.372	0	2.434.633	650.000
2008	323.096	0	2.374.098	650.000
2009	-1.001.019	0	2.557.789	950.000
2010	-1.014.640	0	2.516.739	650.000
2011	-16.8437	0	2.279.109	650.000
2012	-75.7825	0	2.335.741	650.000
2013	88.6703	0	2.690.307	650.000
2014	-490.755	0	2.163.923	650.000
2015	240.938	0	2.213.217	650.000
2016	-314.799	0	2.089.970	650.000

52. Arsyetimi ligjor.

53. Duke pasur parasysh (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së (ii) deklaratat periodike dorëzuar pranë ILDKPKI-së (iii)

provat shkresore të administruara nga Komisioni; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe deklaratimet e shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore.

54. Trupi gjykues vlerëson që për vitin financiar 1998 të bëjë një analizë ligjore në mënyrë integrale, në funksion të një arsyetimi logjik të elementeve faktike, si më poshtë.

55. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çmim të njëjtë për pasurinë apartament shitur në Korçë si në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003 ashtu dhe në deklaratën “Vetting”, përdorur si burim për blerjen e apartamentit, ku aktualisht banon ndodhur në Tiranë, blerë në 1998, në vlerën 2,5 milion lekë.

56. Subjekti i rivlerësimit ka një qëndrim të deklaruar dhe shpjegim se përse çmimi i apartamentit të shitur prej 2,5 milion lekësh u shndërrua në një vlerë më të ulët në kontratën e shitjes prej 1 milion lekësh, duke shpjeguar se ndryshimi i çmimit nga kontrata e shitjes së pasurisë dhe atij të deklaruar në deklarin periodik të vitit 2003 dhe deklaratën “Vetting” ka ardhur për shkak të mospasqyrimit të marrëdhënies së kaparit në shkurt të vitit 1998 në kontratën e shitblerjes të vitit 2002.

57. Në një analizë logjike të përmbajtjes së deklaratës periodike të vitit 2003, vlera e shitjes së banesës në vlerën 22.346.765 lekë referuar çmimit për banesat në qytetin e Korçës, në vitin 2002, nëse pagesa për shitjen e shtëpisë do të ishte e marrë e plotë në këtë vit, ky veprim do të kishte sjellë rritjen e pasurisë dhe pasqyrimin e kësaj rritje në deklaratën periodike të vitit 2003. Por përmbajtja e deklaratës periodike të vitit 2003, ku subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar një shumë të tillë, mbështetet argumentin e tij, për marrjen e kaparit në vitin 1998.

58. Parashikimet ligjore të Kodit Civil se kapari nuk kërkon për efekt vlefshmërie formalizimin me shkresë, apo akt noterial, si mjet për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve civile dhe në këtë mënyrë nuk është e detyrueshme paraqitja e tij në formë shkresore, provojnë se ai nuk ka pasur detyrim ligjor për provimin me shkresë së marrjes së kaparit.

58.1 Shpjegimet e subjekti në përgjigje të pyetësorëve se marrëdhënia e kaparit me blerësin e pasurisë të tij apartamentit ndodhur në Korçë ka qenë pasqyruar në *një deklaratë dore, të cilën nuk e disponon më*, duke u ndodhur në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të një pjese të të ardhurave nga shitja e shtëpisë në Korçë, provuar në këtë mënyrë pamundësinë e tij për ribërjen e një dokumenti që ka humbur e nuk mund të bëhet përsëri ose të merret në rrugë tjetër, e duke u ndodhur ne kushtet e pamundësisë për të paraqitur deklaratën e dorës për marrjen e këtij kapari sipas parashikimeve të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016.

59. Parashikimet ligjore të ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale” amenduar me dekretin nr. 1673, datë 20.12.1996, ndryshuar me ligjin nr. 8189, datë

30.01.1997, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1673, datë 20.12.1996” përcaktojnë se për të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme me vlerë deri në 2 milionë lekë, në periudhën shkurt të vitit 1998, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim ligjor për pagimin e tatimeve për shumën e marrë kapar në vitin 1998.

60. Referuar përgjigjes së kthyer nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, nr. *** prot., datë 02.11.2018, për vlerën minimale të shitjes së banesave në Korçë, sipas të cilës në vitin 2002 vlerë minimale e shitjes së një banese me sipërfaqe sa ajo e subjektit të rivlerësimit do të ishte vlera 22.346.765 lekë dhe në vitin 1998 do të ishte 19.135.345 lekë, duke marrë në konsideratë edhe faktin që apartamenti i subjektit të rivlerësimit, që kishte për destinacion të blerjes bërjen e një dyqan tregtar, në katin e parë të një pallati që ndodhet buzë bulevardit “****” në qendër të qytetit të Korçës, në funksion të një arsjetimi logjik, trupi gjykues, vlerëson se ajo është një provë shkresore që mbështet shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për vlerën e shitjes së apartamentit të subjektit të rivlerësimit në vlerën 2.5 milion lekë.

61. Nga të gjitha faktet e prezantuara më sipër trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë dhe të provojë me provat që njeh legjislacioni procedural situatën faktike, si dhe të japë një shpjegim për rrethanat e pretenduara prej tij në aspektin logjik për sa më poshtë:

- i. për çmimin e përfituar nga shitja e apartamentit në Korçë në vlerën 2.5 milion lekë, përdorur si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë;
- ii. për kaparin e marrë në vitin 1998 si paradhënie për shitjen e shtëpisë në Korçë;
- iii. për mungesën e detyrimit ligjor për pagimin e tatimit për kaparin e marrë në shkurt 1998.

62. Nga provat e administruara në hetim, nuk rezultoi asnjë fakt i dalë që të vërë në dyshim vërtetësinë e kësaj rrethane e shtate të shpjeguar nga subjekti, përkundrazi gjatë hetimit, rezultuan prova të tjera që mbështesnin këtë qëndrim të subjektit të rivlerësimit, përveç deklarimeve noteriale të dhëna nga blerësi i apartamentit në Korçë, vlera provuese e të cilave është e pakonsiderueshme në vlerësimin e trupit gjykues.

63. Në konkluzion të sa më sipër, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, vlera e shtëpisë së shitur në Korçë nga subjekti i rivlerësimit ka qenë 2.5 milion lekë, nga të cilat subjekti i rivlerësimit 1.5 milion lekë i ka marrë kapar në shkurt të vitit 1998 nga blerësi i këtij apartamenti.

64. Pavarësisht detyrimit ligjor për të ardhurat që taten për periudhën kur ato realizohen dhe mungesës së parashikimit ligjor për pagimin e tatimit për kaparin e marrë në shkurt 1998, trupi gjykues, arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e parashikimit të sa ka ndodhur, marrjes së kaparit në vitin 1998 në kontratën e përpiluar në vitin 2002 dhe parashikimit në këtë kontratë se për arsye të mosmbartjes së detyrimit në vite për pagimin e tatimit në lidhje me

shumën 1,5 milion lekë marrë në vitin 1998, si pjesë e të ardhurave të krijuara nga shitja e banesës, kjo shumë përjashtohet nga tatimi që do të paguhej për shitjen e kësaj pasurie.

65. Lidhur me këtë pasaktësi trupi gjykues ka vlerësuar se konsideruar në analizë dhe pas një shqyrtimi të bërë në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, duke u parë në raport dhe e ndërlidhur me një tablo të plotë të qasjes së subjektit të rivlerësimit në raport me detyrimet e tij për deklarimin me vërtetësi e saktësi të pasurive të tij dhe personave të lidhur, si edhe në raport me justifikimin e burimeve të ligjshme për këto pasuri, ajo nuk ka ndikuar në sjelljen e subjektit të rivlerësimit në drejtim të deklarimit të pasurive të tij, e cila është në përputhje me detyrimet ligjore që subjekti i rivlerësimit ka pasur për të bërë ndër vite, në zbatim të legjislacionit që ka rregulluar deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesit të subjekteve të rivlerësimit.

66. Për sa i përket çmimit të deklaruar të blerjes së makinës nga vëllai në vitin 1998.

67. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe të provojë me provat që njeh legjislacioni procedural situatën faktike, si dhe të japë një shpjegim edhe për rrethanat e pretenduara prej tij në aspektin logjik për çmimin e paguar vëllait të tij për makinën e blerë në vitin 1998

68. Gjatë hetimit, nuk rezultuan prova të tjera që mbështesnin deklarimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit, e deklarimin e vitit 2003 për ndihma nga familjarët për blerjen e makinës përveç deklarimeve të dhëna nga vëllai i tij dhe persona të tjerë të familjes, vlera provuese e të cilave është e pakonsiderueshme në vlerësimin e trupit gjykues.

69. Trupi gjykues vendosi të mospranojë shpjegimet e subjektit për pagesat e kryera nga ai për vëllain e tij në lidhje me blerjen e makinës, në vitin 1998, duke vendosur të marrë në konsideratë vlerën e plotë të parashikuar në kontratën e blerjes së kësaj makine në vitin 1998.

70. Për sa i përket shpenzimeve jetike për vitet 1992 - 1998.

71. Në kushtet që Komisioni nuk kishte referenca dhe standarde nga Instituti i Statistikave dhe nga ILDKPKI-ja, për vitet 1992 - 1998, në përlllogaritjen e shpenzimeve jetike për të marrë në konsideratë, trupi gjykues pyeti subjektin e rivlerësimit për shpenzimet e kësaj periudhe.

72. Subjekti i rivlerësimit për këtë periudhë në shpjegimet e tij në përgjigje të barrës së provës, por edhe në seancë dëgjimore shpjegoi se nuk është i sigurt mbi saktësinë e tyre, por preferonte ti deklaronte më shumë se me pak ato, duke i deklaruar ato me përafërsi në 40 % - 50 % të të ardhurave familjare të tij, në referencë të sa kanë rezultuar sipas tabelës së vitit 2008.

73. Analiza financiare për vitin 1998 për të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e pasurive në vitin 1998 në referim të argumentimit të mësipërm do të ishte si më poshtë:

Analizë financiare krahasuese 1992 - 1998	Shuma në lekë
Të ardhura neto vërtetuar nga paga	1,629,423
Paradhënie e marrë për shitje apartamenti në vitin 1998, deklaruar	1,500,000
Universiteti "Fan Noli" Korçë 1996 - 1998	109,110
Total të ardhura (1)	3,238,533
Pagesë kësti 1,2 ap. shoqërisë "****" sh.p.k., datë 09.02.1998	1,900,000
Pagesë blerje makine 12/1998	1.000,000
Shpenzime për jetesë	814,712
Total pagesa për blerje pasuri (2)	3,714,712
Mjete monetare të disponueshme (1-2)	-476.179

74. Trupi gjykues vlerëson se mungesa e likuiditetit për vitin financiar 1998 në shumën prej -476.179 lekësh pas zbritjes së shpenzimeve të deklaruara nga subjekti me përafërsi e në mungesë të referencës ligjore për llogaritjen e shpenzimeve, është shumë e përafërt dhe nuk është në masën që cenon besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vete natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar e duke çmuar se mungesa e këtij likuiditeti nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

75. Autoveturë e përdorur në pronësi, tip "Toyota RAV 4", viti i prodhimit 2003. Vlera 11.000 euro. Blerë nga shtetasi R. R sipas kontratë së shitblerjes, nr. *** rep., nr. *** kol, datë 19.07.2008.

Burimi i krijimit: kursimet nga paga si prokuror dhe paga e bashkëshortes.

76. Kjo pasuri në deklarinimin për vitin 2008 deklarohet, autoveturë, tip "Toyota", në vlerën 11.000 euro, me burim nga të ardhurat personale dhe të bashkëshortes, si dhe në deklaratën "Vetting" në mënyrë të njëjtë.

77. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se referuar shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugorë, "kthim përgjigje", nr. *** prot., datë 02.10.2018, konfirmon se shtetasi Adnan Ç. Kosova, aktualisht ka në pronësi mjetin me targë ***.

78. Me kontratën e shitjes së automjetit, më datë 19.07.2008, me nr. *** rep., nr. *** kol., *shitësi deklaroi se është likuiduar dhe nuk ka pretendime.*

79. Në bazë të të dhënave të administruara, u krye analiza financiare për mundësinë financiare të blerjes së këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit e pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Analiza financiare	2008
Të ardhurat neto nga pagat dhe shpërblimet e subjekti i rivlerësimit	1.736.983
Të ardhura neto të bashkëshortes së subjektit	603.006
Të ardhura të tjera	34.109
Total të ardhura (1)	2.374.098
Pagesë shpenzime jetese	650.000
Shpenzime total	650.000
Ndryshim mj. monetare gj. fillim - gj. fund periudhe	1.038.704
Mjete monetare të disponueshme (1)	2.762.802
Pagesa për blerje pasurie automjet 11.000 euro	1.361.800
Detyrime	0
Pasuri neto (2)	1.361.800
Balanca e fondeve(1-2)	1.401.002

79.1 Bazuar te kjo analizë financiare, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e makinës së tyre në vitin 2008.

80. Gjendje *cash* në vlerë 1.100.000 lekë.

81. Burimi i krijimit: Kursimet nga paga si prokuror dhe paga e bashkëshortes së subjektit gjatë vitit 2016, si dhe nga kursimet e akumuluar ndër vite nga paga si prokuror dhe paga e bashkëshortes

82. Në bazë të të dhënave të administruara u krye analiza financiare për mundësinë financiare të krijimit të kësaj gjendje *cash* duke marrë në konsideratë të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes së tij, dhe kursimet pas zbritjes së kostove të jetesës për periudhën e deklarimeve nga viti 2004 deri në vitin 2016.

83. Bazuar tek analiza financiare, e referuar në tabelën e detajuar në pikën 46 të këtij vendimi, arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur burime të ligjshme për të krijuar gjendjet e kursimeve *cash* në vlerë 1.100.000 lekë.

VI. Konkluzioni për komponentin e vlerësimit të pasurisë.

84. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, për subjektin e rivlerësimit, z. Adnan Kosova, trupi gjykues, vlerëson se ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

85. Në përfundim, trupi gjykues, vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka treguar një qasje korrekte e të sinqertë në raport me deklarimin e tij në deklaratën e pasurisë “Vetting”, por në mënyrë të vazhdueshme edhe në deklaratat e pasurisë në vite, duke e çuar trupin gjykues në përfundimin se ai nuk ka fshehur dhe ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në vijimësi. Për këto arsye, trupi gjykues ka konkluduar se ai ka bërë deklaram të mjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

86. Pasaktësia e konstatuar në hartimin e kontratës së shitjes së pasurisë në Korçë duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit dhe nuk cenon figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut tek drejtësia. Diferenca e konstatuar në analizën financiare të vitit 1998 nuk është në masën që cenon besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare, është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar dhe mungesa e këtij likuiditeti në këtë masë¹, nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

VII. VLERËSIMI I FIGURËS

87. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/206.

88. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, i deklasifikuar me vendim të KDZH-së, nr. ***, datë 27.09.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Adnan Ç. Kosova.

89. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

90. Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni për kontrollin e figurës

¹ Vendimi nr. ***, datë 16.10.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

91. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës.

VIII. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

92. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 03.05.2018.

93. Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar në:

1. Formularin e vetëdeklarimit si dhe të 3 (tre) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
2. 5 (pesë) dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
3. Të dhënat nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, struktura të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ato të administruara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

94. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, i bazuar në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet si më poshtë:

95. Lidhur me aftësitë profesionale, subjekti i rivlerësimit, prokuror Adnand Kosova, interpreton dhe zbaton drejt ligjin. Për sa u përket rast pas rasti, konstatohet se, në të 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vet subjekti, ashtu dhe në 5 dosjet e zgjedhura në mënyrë rastësore me short, gjuha e përdorur në akte është normale, e kuptueshme, logjike dhe është përmbajtur me korrektesë rregullave drejtshkrimore, duke realizuar komunikim të qartë dhe të mbështetur në ligj dhe Rregullat Etike të Prokurorit.

96. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Nisur nga natyra e fushës, ku ka ushtruar detyrën e prokurorit gjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, prokuror Adnand Kosova, ka zbatuar e interpretuar drejt bazën ligjore, mbi të cilën janë hartuar aktet e ndryshme të tij që i përkasin veprimtarisë së Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore dhe si Inspektor i Etikës.

97. Lidhur me arsyetimin ligjor, subjekti i rivlerësimit, prokuror Adnand Kosova, ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Aktet procedurale dhe ligjore të hartuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të akteve ligjore. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Përgjithësisht, përmbajtja e akteve është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje në çdo rast problemeve të ngritura në to. Këto aftësi konstatohen edhe në vlerësimet periodike vjetore të gjetura për subjektin të Sektorin e Burimeve Njerëzore për vlerësimin e tij.

98. Lidhur me aftësitë organizative, subjekti i rivlerësimit, prokuror Adnand Kosova, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit në Drejtorinë Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe krahas saj ka kryer edhe detyrën e Inspektorit të Etikës, në shkallë vendi, i caktuar me Urdhrin nr. ***, datë 19.06.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm. Ai ka deklaruar si ngarkesë pune të detajuar për tre vitet, çka tregon për një ngarkesë relativisht të lartë pune, si pjesë e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, ashtu dhe si Inspektor i Etikës. Nga aktet dhe praktikant e analizuara, nuk u konstatuan vonesa apo zvarritje në veprimet e kryera gjatë ushtrimit të inspektimeve apo kryerjen e verifikimeve të nevojshme për zgjidhje të praktikave të ndryshme, që ka çuar në zgjidhjen sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj dhe urdhrat e udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm. Aftësitë e subjektit dalin në pah veç përmbajtjes së akteve të mësipërme edhe nga vlerësimet periodike vjetore të gjetura për të në Sektorin e Burimeve Njerëzore për vlerësimin e tij

99. Lidhur me aftësinë për të kryer procedurat hetimore, subjekti i rivlerësimit, prokuror Adnand Kosova, ka kryer me kompetencë dhe aftësi, detyrën funksionale të tij, duke ju dhënë rrugë dhe zgjidhje ligjore praktikave të ndryshme dhe inspektimeve të kryera në përbërje të Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të Inspektorit të Etikës. Në aktet e përpiluara prej tij, në çdo rast i referohet dispozitave ligjore përkatëse, si dhe urdhrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Nga aktet e analizuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit gjatë veprimtarisë së tij, ka synuar që të paraqes në mënyrë të shkruar shkelje dhe mangësi të çdo karakteri të konstatuara në veprimtarinë e punës së prokurorëve, të cilat, i ka analizuar me profesionalizëm dhe në përfundim ka dhënë orientimet e tij me qëllim përmirësimin e tyre në të ardhmen. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe në cilësinë e Inspektorit të Etikës, gjatë trajtimit të rasteve me natyrë të shkeljes së etikës nga prokurori.

100. Lidhur me aftësinë për të administruar dosjet, nga studimi i 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura prej tij dhe 5 akteve të përzgjedhura me short, konstatohet që ato janë të rregullta, të sistemuara sipas kronologjisë kohore. Gjithashtu konstatohet që ato janë të plota dhe përfshijnë aktet dhe komunikimet e nevojshme deri në zgjidhjen përfundimtare.

101. Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova, është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Gjatë periudhës së rivlerësimit ndaj prokurorit nuk ka pasur procedime disiplinore e si rrjedhim as masa disiplinore, qoftë në drejtim të anës profesionale, ashtu dhe atë etike.

Subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, edhe për vetë pozicionin që ka pasur si Inspektor i Etikës, ka pasqyruar një komunikim e bashkëpunim korrekt me kolegët, duke shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me ta, por njëkohësisht edhe sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

102. Referuar vlerësimeve të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, në periudhën objekt rivlerësimi, lidhur me etikën, konstatohet se, ai është vlerësuar “shumë mirë” me arsyetimin që, ka përmbushur me korrektësi disiplinën formale lidhur me orarin, paraqitjen zyrtare, etikën, përmbushjen e angazhimeve për të ruajtur të pastër figurën e prokurorit.

103. Lidhur me integritetin, nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Adnand Kosova, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Referuar vlerësimeve vjetore të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm për të në periudhën 2014 - 2016, por dhe nga të dhënat në tërësi, subjekti i rivlerësimit konsiderohet si person me integritet të lartë, i paanshëm dhe objektiv.

104. Lidhur me paanësinë, nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i tij nga shqyrtimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

105. Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimi profesional, në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën dhe i qartë. Po kështu, nga të dhënat e nxjerra nga aktet e vlerësimit të subjektit të rivlerësimit, rezulton se komunikimi, bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve dhe administratës, ka qenë korrekte, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre. Ka shfaqur kompetencë profesionale për çështje të ndryshme, bashkëbisedon pa rezerva dhe është i hapur për diskutim me kolegët, si për çështje që i përkasin fushës ku ai ka qenë i fokusuar, ashtu dhe për çështje të tjera me karakter ligjor e të përgjithshëm.

106. Lidhur me aftësinë për të bashkëpunuar, nga të dhënat që i përkasin subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova, konstatohet se ka cilësi të mira bashkëpunuese, është i gatshëm të punojë në grup, si dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës profesionale me kolegët e tjerë të të njëjtit nivel, ashtu dhe me prokurorë të shkallëve më të ultë, duke pasur dhe cilësinë e inspektorit të etikës. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh procedurat që ndiqen deri në vlerësimin përfundimtar të prokurorëve për çdo vit kalendarik, ku ajo bëhet nga eprori direkt i tij, në rastin konkret nga Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe nisur nga karriera e tij për 10 vitet e fundit, pjesëmarrjen e tij si lektor në tema të ndryshme, del qartë në pah aftësia e tij për të bashkëpunuar, si me kolegët dhe administratën e prokurorisë, ashtu edhe me institucionet shtetërore, me qytetarët etj.

107. Lidhur me gatishmërinë për t'u angazhuar, nisur nga vëzhgimi dhe analiza e materialit që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova, konstatohet angazhimi dhe pjesëmarrja në trajnime të zhvilluara si brenda edhe jashtë vendit. Gjithashtu, subjekti është angazhuar në vazhdimësi, me cilësinë e trajnuesit në programe të ndryshme të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës.

108. Pas shqyrtimit të Raportit të hartuar nga Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme, si më sipër, Komisioni, nuk gjeti asnjë indice apo elementë që mund të ngrënë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Konkluzione për komponentin e vlerësimit profesional

109. Lidhur me vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të vlerësimit, sipas pikës a) trupi gjykues bazuar në (i) konstatimet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se:

110. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

IX. DENONCIME

111. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Adnand Kosova, janë depozituar 2 denoncime.

112. Denoncim nga shtetasi Ll. J, më datë 11.01.2018, me objekt: Aftësitë profesionale, hetim jo i rregullt ligjor.

113. Siç rezultoi nga raporti i vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, në pjesën e III-të të tij mbi të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore - vlerësimet) denoncimi i shtetasit Ll. J është trajtuar nga Prokuroria e Përgjithshme e cila me shkresën nr. ***, datë 10.09.2013, i ka kthyer përgjigje ankuesit.

114. Denoncim nga shtetasi R. M, më datë 23.01.2018, për Adnand Kosova, B. H, V. T, B. I. dhe V. K, me objekt: Aftësitë profesionale, gjykim i padrejtë.

115. Pas shqyrtimit të dy denoncimeve të paraqitura në raport me elementët e nenit 53 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se *“1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim.*

2. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit”, nga Komisioni nuk u gjetën indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo për veprime apo elementë që cenojnë figurën e prokurorit.

KONKLuzioni PëRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59 pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 20.12.2018

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Genta Tafa (BUNGO)
Anëtare

Xhensila PINE
Relatore

Fiorela Mandro
Sekretare gjyqësore

International Monitoring Operation
*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*



Funded by the European Union

To the
Independent Qualification Commission
Rruga Kavaje, 6-9
Tirana
Albania

Case Number **GPO-TIR-1-07**

Assessee **Adnan Kosova**

DISSENTING OPINION OF THE INTERNATIONAL OBSERVER

Pursuant to Art. 55, par. 5 of Law No. 84/2016 On the Transitional Evaluation of Judges and Prosecutors in the Republic of Albania (hereby “Vetting Law”), I hereby file my dissenting opinion on the Independent Qualification Commission’s (hereinafter “IQC”) decision which confirmed into duty the assessee Adnan Kosova.

More specifically, it is hereby argued that it is not proved the existence of the source of ALL 1.5 million for the purchase of the 98 m2 apartment in Rruga “***” in Tirana (as declared in the vetting declaration), alleged as deriving from the previous sale of an apartment in Korça. Therefore, it is my opinion that the assessee failed to credibly explain the lawful origin of that assets. Alternatively, the stipulated contract between the assessee - Mr. Adnan Kosova - and Mr. E. K for the apartment in Korça has been concluded with fraudulent purposes, in order to avoid the payment of taxes over the amount of ALL 2.5 million. This behavior could additionally seriously affect the public trust and confidence in the justice institutions that the re-evaluation process aims at re-establishing.

Either way, it is my opinion that the assessee Mr. Adnan Kosova should be dismissed from office pursuant to the combined reading of Art. 58, par. 1, sub c) with Art. 59, par. 1, sub a) and

par. 2 and Art. 61, par. 3 and par. 5 of the Vetting Law, having in mind Art. 179/b, par.1 of the Constitution and Art. D of the Annex to the Constitution.

With regards to the unproven sources of ALL 1.5 million, it should be pointed out that assets of Mr. Kosova declared in the Vetting Declaration must be subject to a thorough check/assessment, in order to ensure that the public official is a person of integrity and to establish whether the entire wealth is lawful. We cannot exempt from the check/assessment the assets acquired before the 2003 which, however, it must be analyzed on a case-by-case basis in terms of assessment of the credible explanation and supporting evidence concerning its lawful origin. For that reason, flexible approach is required for events that occurred many years back in the past, but explanations must not be unreasonable and/or cannot be accepted where they run against the applicable relevant legal provisions of the time or when certain behaviors or legal transactions took place with fraudulent purposes.

Regarding the financial capacity to buy the apartment in Tirana, the assessee stated² that the price of the apartment sold in Korça was ALL 2.5 million out of which ALL 1.5 million was taken as down payment for the sale of the apartment in Korça from Mr. E. K – who was only 25 years old at the time of the reported events. The assessee affirmed that ALL 1.5 million was given to him in coincidence of his individual off-the-plan contract concluded, on 9 February 1998, with *** Sh.p.K for the apartment in Tirana. The assessee does not present any documentation concerning the down payment made by E. K. Nor this is mentioned in the final sale contract for the apartment of Korça. In contrast, the purchase contract which has been signed by the parties four years later in 2002 registers an overall selling price of ALL 1 million without mentioning any down payment.

The assessee, in order to prove the down payment of ALL 1.5 million which allegedly occurred in 1998 presented a notarial declaration dated 20 August 2018³ from E. K. The ALL 2.5 million price as a source of income for the purchase of the apartment in Tirana was also declared in the 2003 declaration by the assessee.

The IQC has substantially accepted the assessee’s explanations, by making reference to the fact that the “[...] legal provisions of the civil code determine that in order for the down payment to be valid, it is not necessary to be supported by a written document, notarial document, as a means to secure the execution of civil obligations [...]”⁴

The International Observer (hereinafter “IO”) would like to recall, first of all, the definition that Art. 601 of the Civil Code provides about “down-payment”. It reads as follows: “Downpayment is the pecuniary amount that one of the parties gives to the other on the account of which shall be paid **under the contract**, to the effect of establishing the conclusion of the contract and ensuring its enforcement.”⁵ (emphasis added)

² See the replies to the Question 2 in the questionnaire that the assessee received on 12 September 2018.

³ Nr. *** rep, Nr. *** Kol, Notary B. Z.

⁴ Quotation from the text in par. 58 of the decision.

⁵ Art. 601 of the Civil Code.

A down payment foresees the existence of a contract. In our case a contract for the sale of the apartment in Korça did not exist when the alleged first payment took place and, therefore, it cannot be considered proved according to a correct application of the principles enshrined in Art. 32, par. 2 of the Vetting Law.

Art. 750 of the Civil Code foresees that “[t]he sale of immovable property shall occur in the way foreseen in Article 83 of this Code, otherwise it shall be invalid”. Whereas Art. 83 of the Civil Code states that “The legal transaction made for the transfer of ownership of immovable assets and of the real rights over them, must be notarized and registered, otherwise it is not valid. The legal transaction that is not made in the form expressly required by law is not valid. In other cases, the legal transaction is valid, but it cannot be proved by witnesses.”

It is the IO’s opinion that in only cases when the assessee and Mr. E. K had a contract pursuant to Art. 83 of the Civil Code, mentioning thereby the amount given as down payment – and the remaining ALL 1 million to be disbursed at later stage - then the assessee’s version could be credible according to a correct interpretation of Art. 32, par. 2 of the Vetting Law. Therefore, for his version to be credible, the assessee should have concluded a conditional sale of immovable property, as per Art. 751 of the Civil Code⁶. Parties (assessee and E. K) could subordinate the transfer of ownership of the apartment in Korça to the suspensive condition of payment of the full amount of the price - that would have occurred at later stage. In that event, even the provisions of Art. 710, par. 2 of the Civil Code⁷ would have applied.

It is worth reminding Art. 49, par. 4 of the Vetting Law, as also recalled in decision 5/2018 dated 26 July 2018, of the Special Appeal Chamber of the Constitutional Court, according to which “[...] The Commission or the Appeal Chamber shall base decisions only on documents from known sources, or evidence which is reliable, is strongly consistent with other evidence. They are entitled, based on their internal conviction, to take into account any indicia as part of the overall evaluation of evidence [...]”⁸

Another possible scenario, instead, is the one having the assessee evading the relevant taxes by declaring the only amount of ALL 1 million in the contract at later stage. Thus excluding the ALL 1.5 million previously provided as down payment.

In IO’s opinion, it is irrelevant that an eventual down payment (where ascertained) occurred several years earlier, as the contract for the selling of the apartment in Korça had to refer to the full price of the apartment - once concluded - according to the provisions of Art. 83 of the Civil Code (and, eventually, to the amount which was already paid). In that way, payment of taxes due when the contract was validly concluded - according to the provisions stipulated by the law

⁶ “The conditional sale of immovable property items shall be entered into the registers of immovable property, upon the condition being established.” (Art. 751, Civil Code).

⁷ “The main obligations of the seller are: [...] 2. where the acquisition of the ownership over the property item or of real rights thereon is not an immediate consequence of the contract, he shall hand over the entire pertinent documentation regarding the acquisition of the ownership thereon, under the conditions contained in the contracts or in the law [...]”

⁸ See paras. 62, 63, 64 and 65 of Decision No. 4/2018 of the Special Appeal Chamber of the Constitutional Court (26 July 2018) on the assessee B. T, where the Appeal Chamber rejected some claims raised by the appellant as he did not support them with documents.

- could be ensured. That is the correct interpretation, in the IO's opinion, of the relevant norms of the Civil Code.

Art. 663 of the Civil Code states that "The conditions necessary for the existence of a contract are: consent of a party assuming the obligation, legal grounds whereon the obligation is building, scope making up the contents of the contract and its form required by law." It is important to remind, within this context, that Art. 676 of the Civil Code affirms that "[t]he contract shall be considered to be concluded where the parties have mutually expressed their will, agreeing on all its essential conditions [...]"; the indication of the correct (whole amount of the) price must be considered an "essential condition" or element of the contract for the purchase of the apartment in Korça.

Where this correct indication of the price is missing, in a situation where it prevented the payment of some taxes due at the moment of the conclusion of the contract in the forms envisaged by the law, it is possible to argue that the scope of the contract is against Art. 678 of the Civil Code, mandating that "[t]he scope of the contract shall be possible, lawful, defined or definable." Said in other words, a contract framed to avoid the payment of taxes at a certain moment, presents "[...] legal grounds unlawful" because the "contract becomes an instrument to avoid the implementation of a norm", according to the wording of art. 677 of the Civil Code. In our case a norm which can be found in the tax related legislation.

In light of the above, it is the IO's opinion that IQC erred in accepting the assessee's explanations under the submitted factual circumstances. It is completely illogical to believe into a down payment of the amount of ALL 1.5 million based on an inexistent or otherwise invalid contract – moreover allegedly concluded with a person, Mr. E. K, rather young in 1998 Various notarial declarations produced in 2018 and related to the events claimed by the assessee, in this regard cannot be considered and are not reliable.

Alternatively, according to a possible second interpretative option, the contract concluded by the assessee and Mr. E. K was done to avoid the payment of taxes in the amount of ALL 2.5 million; in this case, besides being this behavior relevant in the assessment of the ethics of the assessee, the untaxed sum amounting to the value of ALL 1.5 ALL million cannot be considered legitimate income⁹ and, as a result, the assessee cannot legally justify the source of the creation of the house in Tirana.

Therefore, the IQC should have argued along one of the lines presented in this opinion and it should have reached a different conclusion concerning the re-evaluation process for the assessee Mr. Adnan Kosova.

Theo Jacobs
International Observer

⁹ See Art. D, par. 3 of the Annex to the Constitution of the Republic of Albania.